



**ODA E AVOKATËVE TË KOSOVËS
ADVOKATSKA KOMORA KOSOVA
KOSOVA BAR ASSOCIATION**

Në bazë të nenit 21. par. 1 dhe 41 par. 3 pika 3 e Ligjit nr. 04/L-193 për avokatinë “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës” nr. 20 të dt. 31 maj 2013, Kuvendi i Odës së Avokatëve të Kosovës në Prishtinë, në seancën e datës 18 mars 2017, bie këtë

RREGULLORE

PËR TARIFAT E AVOKATËVE

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1.

Me këtë Rregullore përcaktohen pagesat tarifave për punën e avokatëve dhe kompensimin e shpenzimeve për punën e avokatëve.

Neni 2.

1. Kur avokati punën e kryen jashtë vendit, mundet që shpërblimin dhe kompensimin e shpenzimeve të e inkasojë sipas tarifës së avokatëve të atij vendi.
2. Kur avokati kryen punë për subjektin e huaj fizik apo juridik, mundet që shpërblimin dhe kompensimin e shpenzimeve t’i kryejë sipas kësaj Rregullore apo sipas dispozitave respektive të avokatëve të vendit prej nga e ka origjinën subjekti për të cilin avokati e kryen punën.
3. Dispozitat për pagesat sipas tarifave për punën e avokatëve dhe kompensimin e shpenzimeve për punën e avokatëve të vendit të huaj mund të aplikohen edhe te subjekti fizik apo juridik vendas, nëse atij puna duhet t’i kryhet në vendin e huaj.
4. Pagesat sipas tarifave për punën e avokatëve dhe kompensimin e shpenzimeve për punën e avokatëve të vendit të huaj avokati mundë të e aplikoj edhe në rast se përfaqësimin e bënë në botën e jashtme në formën e shkruar.

Neni 3.

Nëse avokati për subjekt juridik apo fizik është i angazhuar për përfaqësim apo mbrojtje dhe për kryerje e shërbimeve nga lëmi juridik në mënyrë të përhershme, me klientin e tillë mund të lidhë kontratë për përfaqësimin dhe shpërblimin në lartësi mujore paushalle.

Neni 4.

1. Pavarësisht dispozitave tjera të kësaj tarife, Avokati dhe Klienti ose personi i autorizuar mundë të kontraktojnë shpërblimin për shërbimet e Avokatit dhe shpenzimet shoqëruese me marrëveshje të lirë ndërmjet tyre.
2. Marrëveshja sipas paragrafit paraparak zbatohet në bazë të:
 - a. Marrëveshjes – kontratës me shkrim ndërmjet Avokatit dhe Klientit ose personit të autorizuar, apo
 - b. Faturës së lëshuar nga Avokati, të nënshkruar nga Klienti apo subjekti i autorizuar.
3. Avokati dhe klienti mundë të kontraktojnë shpërblimin edhe nën vlerat e caktuara me këtë Rregullore, por jo nën 50 % të vlerës së caktuar me numrat tarifor të kësaj Rregulloreje.

II. KOMPENSIMI I SHPENZIMEVE

Neni 5.

1. Për punën e kryer jashtë selisë së zyrës avokatit, avokatit i takon kompensimi për shpenzime të udhëtimit, kompensimi për shkak të mungesës në zyrë si dhe mëditja.
2. Avokatit i takon:
 - a. për udhëtim në relacionet nder urbane, në lartësi të biletës së udhëtimit,
 - b. për udhëtim në relacionet urbane, në lartësi të auto taksive,
 - c. për përdorimin e automjetit personal në lartësi të 30 % të vlerës së karburantit më të shtrenjtë për 1 km të kaluar,
 - d. për mungesën nga zyra, avokatit i takon kompensimi në lartësi të shumës prej 25% të kompensimit të paraparë me këtë tarifë.
3. Mëditja dhe shpenzimet e fjetjes, avokatit i pranohen në lartësi siç parashihet me dispozita ligjore për gjyqtarët e gjykatave themelore.

III. PAGESA

Neni 6.

1. Pagesat bëhen me para të gatshme ose përmes llogarisë bankare.
2. Avokatit, sipas marrëveshjes me palën, mund t'i bëhet pagesa edhe para kryerjes së punës. Avokati ka të drejtë që të kërkoj paradhëdhënie.
3. Avokati ka të drejtë që shumat e shpenzimeve nga neni paraparak i kësaj tarife të i inkasojë që më parë.
4. Me kërkesë të palës, me rastin e pagesave, avokati është i detyruar që të ia lëshojë dëftesën e vulosur, të specifikuar për shumat e inkasuara.

Neni 7.

Shpërblimi për punën e kryer përcaktohet sipas tarifës në fuqi apo asaj që ka qenë në fuqi në kohën kur është kryer puna. E drejta për të përcaktuar se cila tarifë do të aplikohet, ajo e kohës kur është kryer puna apo kur kryhet pagesa, i takon avokatit.

IV. SHPËRBLIMI PËR PUNËN E AVOKATIT

1. PROCEDURA PENALE

Mbrojtja e të pandehurit/akuzuarit

Numri tarifor 1.

1. Për mbrojtjen e të pandehurit/akuzuarit, për çdo ditë të asistimit në shqyrtimin fillestar dhe shqyrtimin e dytë, në shqyrtimin gjyqësor, asistimit në procedurën paraprake, asistimi me rastin e procedimit në Polici, seanca dëgjimore në prokurori, në procedurën përgatitore të të miturit, asistimi në shikimin në vendin e ngjarjes, në rikonstruktime, ekspertime, vizitën në burg, azhurnimi i çështjes dhe në të gjitha veprimet të cilat zbatohen jashtë ndërtesës së policisë, prokurorisë apo gjykatës, avokatit i takon shpërblimi:
 - a. për çështje penale nga kompetenca e Departamentit të përgjithshëm, shpërblimi në lartësi prej 120 €.
 - b. për çështje penale nga kompetenca e Departamentit të krimeve të rënda apo për të mitur, për vepra penale ku parashihet dënimi deri në 10 vjet burgim, në lartësi prej 150 €.

- c. për çështje penale nga kompetenca e Departamentit të krimeve të rënda apo për z[ë]mitur, për vepra penale ku parashihet dënimi me mbi 10 vjet, në lartësi prej 200 €.
2. Për procedimet e caktuara që nuk mbahen, përkatësisht të shtyra pa fajin e avokatit, avokatit i takon shpërblimi prej 50 % të shumave të lartcituara.

Përfaqësimi i të dëmtuarit

Numri tarifor 2.

Për përfaqësimin e të dëmtuarit në çështje penale, përshtatshmerisht avokatit i takon shpërblimi i përcaktuar me numër tarifor 1 (një).

Përpilimi i parashtresave penale

Numri tarifor 3.

1. Për përpilimin e kallëzimit penal, avokatit i takon shpërblimi sipas bazave fillestare të përcaktuara me nr. tarifor 1. dhe 2. të kësaj Rregulloreje.
2. Për përpilimin e të gjitha parashtresave të tjera në procedurën penale, avokatit i takon 50 % i shpërblimit të përcaktuar në paragrafin paraprak të këtij numri tarifor.

Mjetet juridike në çështje penale

Numri tarifor 4.

Për përpilimin e mjeteve juridike, avokatit i takon shpërblimi në lartësi të dyfishit të paraparë sipas nr. tarifor 1.përkatësishtë sipas nr. tarifor 2.

Numri tarifor 5.

Për përpilimin e ankesës kundër aktvendimit për caktimin apo vazhdimin e paraburgimit apo kundër aktvendimit për refuzimin e kërkesës për rishikimin e procedurës apo çfarëdo aktvendimi në procedurën penale, avokatit i takon shpërblimi në lartësi të numrit tarifor 1.

1. PROCEDURAT CIVILE E TË TJERA

Përpilimi i parashtresave

Numri tarifor 6.

1. Për përpilimin e parashtresave me të cilat iniciohet zhvillimi i procedurës civile, kontestimore, jo kontestimore, ekonomike, administrative, tatimore,

doganore apo cilës do procedurë para gjykatës apo organit tjetër, avokatit i takon shpërblimi:

➤ në çështjet sipas vlerës së çështjes juridike, dhe atë:

- a) për çështje juridike, vlera e të cilave nuk kalon shumë e kontestit të vlerës së vogël, shuma me bazë fillestare prej 60 euro;
- b) për çështje juridike vlera e të cilave e kalon shumë e kontestit të vlerës së vogël deri në vlerën prej 10.000 euro, shuma prej 80 euro;
- c) për çështje juridike vlera e të cilave është 10.000 euro e më lartë, shuma me bazë fillestare prej 160,00 euro;
- d) për çështje juridike vlera e të cilave është 100.000 euro e më lartë, shuma me bazë fillestare prej 250,00 euro;

➤ në çështjet sipas vlerës së çështjes juridike, dhe atë

- e) për çështje juridike, kontestet e pengimit të posedimit, shuma me bazë fillestare prej 80 euro;
 - f) për çështje juridike, sipas propozimit për shkurorëzim me marrëveshje, shuma me bazë fillestare prej 80 euro,
 - g) për çështje juridike të shkurorëzimit me padi, me apo pa kërkesë lidhur me besimin e fëmijëve dhe gjykimin e kontributit për mbajtje dhe ushqim, shuma me bazë fillestare prej 120,00 euro.
 - h) Për çështje juridiko administrative pranë institucioneve shtetërore ose personave juridik, kur ajo çështje nuk ka vlerë të caktuar monetare, shpërblimi llogaritet me bazën tarifore prej 160,00 euro
2. Për përpilimin e përgjigjes në padi, prapësimit në aktvendim për lejimin e përmbarimit apo të masës së sigurisë apo masës së përkohshme, dhe parashtresave të tjera të arsyetuara të cilat përbëjnë pretendime faktike dhe juridike, avokatit i takon shpërblimi si në paragrafin 1. të këtij nr. tarifor.
 3. Nëse më shumë kërkesa kumulativisht janë përfshirë në një padi apo propozim, avokatit i takon shpërblimi i plotë për parashtresën e përpiluar dhe rritja për 50 %.

Përfaqësimi në seanca për çështje civile dhe të tjera

Numri tarifor 7.

1. Për përfaqësim në seanca për çështje civile dhe të tjera avokatit i takon:

- për çdo seancë shpërblimi i përcaktuar si për parashtresa, siç është paraparë në numrin tarifor 6. për parashtresat inicuese,
 - për çdo seancë të shtyrë pa fajin e avokatit, shuma prej 50 % të shpërblimit nga paragrafi paraprak e këtij numri tarifor.
2. Shpërblimi si në paragrafi 1. të këtij numri tarifor, avokatit i takon edhe për azhurnimin e çështjes, asistim me rastin e ekspertimit, shikimit në vendin e ngjarjes si dhe veprimet procedurale që ndërmerren jashtë ndërtesës së Gjykatës.
 3. Për përpilimin e parashtresave dhe përfaqësim në seanca për çështje civile të cilat i referohen arbitrazhës si dhe kontesteve me element të huaj, zbatohet rritje për 100% e numrit tarifor 6. dhe 7.

Përfaqësimet në procedurat e tjera

Numri tarifor 8.

1. Në çështjet para arbitrazheve, organe ndërmjetësuese, në çështjet administrativo-fiskale, doganore, kundërvajtëse apo disiplinore, apo para bordeve përkatëse apo për procedura të pa parapara shprehimisht me këtë tarifë, aplikohen shpërblimet në lartësitë e përcaktuara me nr. tarifor 6. dhe 7.
2. Për mbrojtjen e të pandehurit apo përfaqësim në procedurën disiplinore, kundërvajtëse, pa vlerë monetare të përcaktuar, avokatit i takon shpërblimi në shumën prej 60 €.

Mjetet juridike në çështjet civile dhe të tjera

Numri tarifor 9 .

Për përpilimin e mjeteve juridike, avokatit i takon shpërblimi i dyfishuar nga shpërblimi i paraparë për parashtresat me të cilat iniciohet procedura, në përputhje me numrin tarifor 6. (për padi, kërkesë, prapësim etj.)

Përfaqësimi i më shumë palëve

Numri tarifor 10.

Kur avokati përfaqëson dy apo më shumë palë ose nëse si palë kundërshtare ka më shumë persona, për përpilimin e të gjitha parashtresave dhe për përfaqësimet në seanca gjyqësore, avokatit i takon shpërblimi i rritur për 50 % për palën e dytë dhe secilën të mëtejshme por jo më shumë se deri në trefishin e shumës së paraparë me këtë Rregullore.

Ne rastet kur vlera e kontestit është mbi 100.000 euro rritja nga paragrafi paraprak llogaritet në lartësi prej 25%.

Përfaqësimi jashtë orarit të punës.

Numri tarifor 11.

Për punën të cilin avokati duhet të kryej jashtë orarit të përcaktuar të punës të organit para së cilit çështja procedohet apo ditëve të vikendit dhe të festave, kompensimi i paraparë me këtë tarifë rritet për 25 %.

1. PËRPILIMI I DOKUMENTEVE

Numri tarifor 12.

1. Për përpilimin e të gjitha dokumenteve për punët juridike të njëanshme apo të dy apo më shumanshme gjatë jetës apo për rastin e vdekjes, kontratave, ujdive, testamentit, legatit, avokati mund të aplikojë shpërblimin e paraparë me numrin tarifor 6. apo që shpërblimin të ia llogarisë në lartësi proporcionale me vlerën e tregut për pasurinë që është çështje e punës juridike, por më së shumti deri 1 % të asaj vlere.
2. Kur lëndë e çështjes juridike janë dhëniet e përkohshme apo të kohëpaskohshme, si qiraja, renta etj. vlera e tregut përcaktohet me mbledhjen e dhënieve të përkohshme prej 1 (një) viti.
3. Për përpilimin e dokumenteve për punët juridike kur vlera nuk është e përcaktuar, avokatit i takon shpërblimi përshtatshëm në lartësi të paraparë me numrin tarifor 6. pika 1. nën-pika e. f. g. të tarifës së kësaj Rregulloreje.

2. DISPOZITAT E PËRBASHKËTA

Këshillat me mendimet juridike

Numri tarifor 13.

1. Për këshillë juridike verbale dhe mendim, avokatit i takon 30 %, ndërsa në rastet më të komplikuar 50 % nga shpërblimi i paraparë me numrin tarifor 1. 2. dhe 8, të kësaj tarife.
2. Për këshillë apo mendim juridik të shkruar, avokatit i takon shpërblimi i paraparë me numrin tarifor 6. të kësaj Rregulloreje.

Mbrojtja dhe përfaqësimi në shqyrtime, seanca e tjera

Numri tarifor 14.

1. Për mbrojtje dhe përfaqësime në shqyrtime, seanca, shikime në vend, ekspertime dhe që të gjitha veprimet që organi gjegjës i zbaton në ndërtesën ku organi ka selinë apo jashtë selisë së organit, avokatit i takon edhe shpërblimi për çdo orë të filluar në lartësi prej 30 % nga shuma me bazë fillestare sipas tarifës së kësaj Rregulloreje, duke llogaritur kohën nga momenti kur fillimi i veprimit në fjalë ka qenë i caktuar të filloj e deri në përfundim.
2. Avokati ka të drejtë në shpërblimin nga paragrafi paraprak edhe nëse asiston në mbledhje të organeve qeverisëse ke personat juridik, borde, veprime të ndërmjetësimit apo për takime me persona fizik dhe juridik kur diskutohet lidhur me çështje faktike dhe juridike.
3. Për konsultim me të pandehurin, të akuzuarin apo të gjykuarin, klientin në çështjet civile dhe të tjera, avokatit i takon shpërblimi në lartësi prej 50 % nga shpërblimi i përcaktuar me numrin tarifor 1. 7. 8. dhe 10 të kësaj Rregulloreje.

Shqyrtimi i shkresave

Numri tarifor 15.

Avokatit i takon shpërblimi:

- 1) për shqyrtimin e shkresave në lartësi prej 50 % të shpërblimit të paraparë me numrin tarifor 1. 7. dhe 8. të kësaj Rregulloreje.
- 2) për shikimin në librat kadastrale dhe në librat e tjera publike, për nxjerrjen ekstrakteve nga librat publike, për sigurimin e vërtetimit të plotfuqishmërisë dhe të përmbarushmërisë së vendimeve gjyqësore apo administrativ, avokatit i takon shpërblimi në lartësi prej 50 % të përcaktuar me nr. tarifor 1., 2. 6. dhe 8. të kësaj Rregulloreje.

Shkresat dhe vërejtjet

Numri tarifor 16.

Për përpilimin e vërejtjeve apo të parashtrësive palës kundërshtare në procedurë me të cilat kërkohet përmbushja e ndonjë prestimi apo përmbytja nga ndonjë veprim, në çështjet që janë me vlerë, avokatit i takon shpërblimi në lartësi prej 50 % nga shpërblimi nga pika 1. e numrit tarifor 7. të kësaj Rregulloreje.

Vlera paushalle për veprime sporadike

Numri tarifor 17.

Avokati ka të drejtë në inkasimin e shumës paushalle në lartësi prej 30 % nga shuma e përgjithshme e paraparë për veprimin përkatës të parapara me nr. tarifor bazë ndërsa për veprime nga nr. tarifor 12. aplikohet shuma proporcionale në përqindje.

Neni 8.

1. Për veprimet e pa parapara me këtë Rregullore, kjo Rregullore aplikohet në mënyrë të përshtatshme.
2. Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit nga Kuvendi i Odës së Avokatëve të Kosovës, me datë 18.03.2017.
3. Këshilli drejtues në harmoni me këtë rregullore harton ekstraktin tabelar të tarifave sipas kësaj Rregullore, me të cilin rast shumat e përcaktuara mund të rrumbullaksohen, ashtu që shumat prej 0,01 – 0,99 fshihen fare.
4. Veprimet në kundërshtim me këtë Rregullore trajtohen shkelje disiplinore, të cilat më përparësisht rregullohen me dispozita normative të OAK.
5. Në ditën e hyrjes në fuqi të kësaj Tarife shfuqizohet Rregullorja e aprovuar me dt. 20.12.2014 që ka qenë në fuqi nga data 01 Janar 2015.

Datë 18.03.2017



Kryetari i OAK
Osman Havolli

A handwritten signature in blue ink, which appears to be 'Osman Havolli', written over a white background.

EKSTRAT TABELAR

nga Tarifa e avokatëve të Kosovës

Nr. tarifor 1. dhe 2. - Mbrojtja dhe përfaqësimi në çështjet penale:

Mbrojtja e të dyshuarit, të pandehurit dhe përfaqësimi i të dëmtuarit	Baza	30 % për çdo orë të filluar	Paushall i 30 %	Gjithsejtë:
Për veprë penale nga kompetenca e Departamentit të përgjithshëm të Gjykatës/Prokurorisë.	120€	36 €	46,80 €	202,80 €
Për veprë penale nga kompetenca e Departamentit të për krime të rënda të Gjykatës/Prokurorisë për veprë penale për të cilat parashihet dënimi deri në dhjet vjet burg	150 €	45 €	58,50 €	253,50 €
Për veprë penale për të cilat parashihet dënimi dhjet e më shumë vjet burg dhe krimet e rënda, neni 22 i KPPRK	200 €	60 €	78 €	338 €

Nr. tarifor 3, 4 dhe 5 – Përpilimi i parashtrësve në procedurën penale:

Lloji i parashtrësve penale	Baza	P. 30 %	Gjithsejtë:
Përpilimi i kallëzimit penal, ankesës për caktim dhe vazhdim të paraburgimit kundër aktvendimit për refuzim të kërkesës për rishikim të procedurës apo aktvendimeve tjera penale.			
Për veprë penale nga kompetenca e Departamentit të përgjithshëm të Gjykatës /Prokurorisë.	120 €	36 €	156 €
Për veprë penale nga kompetenca e Depart. të krimeve të rënda të Gjykatës /Prokurorisë, për v.p. për të cilat parashihet dënimi deri në dhjet vjet burg	150 €	45 €	195 €
Për veprë penale për të cilat parashihet dënimi dhjet e më shumë vjet burg dhe krimet e rënda – neni 22 i KPPK.	200 €	60 €	260 €

Nr. tarifor 6. – Përpilimi i parashtrësve në procedurën civile dhe procedurat tjera:

Lloji i parashtr.	Vlera e çështjes	mbi një palë	Baza	Paushalli 30 %	Gjithsejtë
Padi apo kërkesa tjera	Kontest i vlerës së vogël		60 €	18 €	78 €
	Për paditësin/të paditurin e dytë:	+ 50 %	90 €	27 €	117 €
	Për paditësin/të paditurin e tretë:	+ 50 %	120 €	36 €	156 €
	Për paditësin/ të paditurin e katër:	+ 50 %	150 €	45 €	195 €
	Për paditësin/ të paditurin e pestë:	+50 %	180 €	54 €	234 €
	Kontest me vlerë mbi kontestin e vlerës së vogël e deri në 10.000 €		80 €	24 €	104 €
	Për paditësin / të paditurin e dytë:	+ 50 %	120 €	36,00 €	156 €
	Për paditësin / të paditurin e tretë:	+ 50 %	160 €	48,00 €	208 €
	Për paditësin / të paditurin e katër:	+ 50 %	200 €	60,00 €	260 €
	Për paditësin / të paditurin e pestë:	+50 %	240 €	72,00 €	312 €
	Kontesti me vlerë prej 10.000 € e më lartë		160 €	48 €	208 €
	Për paditësin / të paditurin e dytë:	+ 50 %	240 €	72 €	312 €
	Për paditësin / të paditurin e tretë:	+50 %	320 €	90 €	416 €
	Për paditësin / të paditurin e katër:	+ 50 %	400 €	120 €	520 €
	Për paditësin / të paditurin e pestë:	+50 %	480 €	144 €	624 €
	Kontesti me vlerë prej 100.000 € e më lartë		250 €	75 €	325 €
Për paditësin / të paditurin e dytë:	+25 %	312,5 €	93,75 €	406,25 €	
Për paditësin / të paditurin e tretë:	+25 %	375 €	112,5 €	487,5 €	
Për paditësin / të paditurin e katër:	+25 %	437,5€	131,25 €	568,75 €	
Për paditësin / të paditurin e pestë:	+ 25 %	500 €	150 €	650 €	

Lloji i parashtrësive	Vlera e çështjes		Baza	Klauzul. 50%	Paushalli 30 %	Gjithsejtë:
Përmbarrim në bazë të titullit përmbarrimor me vlerë deri në lartësinë e kontestit të vlerës së vogël			60 €	30, €	27 €	117 €
Për kreditorin dytë / debitorin e dytë:	+ 50 %	90 €	45 €	40,50 €	175,50 €	
Për kreditorin tretë / debitorin e tretë:	+ 50 %	120 €	60 €	54 €	234 €	
Për kreditorin katërt / debitorin e katërt:	+50 %	150 €	75 €	58,5 €	292,5 €	
Për kreditorin pestë / debitorin e pestë:	+50 %	180 €	90 €	81 €	351 €	
Përmbarrim në bazë të titullit përmbarrimor me vlerë mbi lartësinë e kontestit të vlerës së vogël			80 €	40,€	36 €	156 €
Për kreditorin dytë / debitorin e dytë:	+ 50 %	120 €	60 €	54 €	234 €	
Për kreditorin tretë / debitorin e tretë:	+ 50 %	160 €	80 €	72 €	312 €	
Për kreditorin katërt / debitorin e katërt:	+50 %	200 €	100 €	90 €	390 €	
Për kreditorin pestë / debitorin e pestë:	+50 %	240 €	120 €	108 €	468 €	
Përmbarrim në bazë të titullit përmbarrimor me vlerë 10.000, € e më lartë			160 €	80 €	72 €	312 €
Për kreditorin dytë / debitorin e dytë:	+ 50 %	240 €	120 €	108 €	468 €	
Për kreditorin tretë / debitorin e tretë:	+50 %	320 €	160 €	144 €	624 €	
Për kreditorin katërt / debitorin e katërt:	+ 50 %	400 €	200 €	180 €	780 €	
Për kreditorin pestë / debitorin e pestë:	+ 50 %	480 €	240 €	216 €	936 €	
Përmbarrim në bazë të titullit përmbarrimor me vlerë 100.000, € e më lartë			250 €	125 €	112.5 €	487 €
Për kreditorin dytë / debitorin e dytë:	+ 25 %	312.5 €	187,5 €	93,70 €	406 €	
Për kreditorin tretë / debitorin e tretë:	+25 %	375 €	112,5 €	146,25€	633,75 €	
Për kreditorin katërt / debitorin e katërt:	+ 25 %	437.5€	131,5 €	170,62€	739,375 €	
Për kreditorin pestë / debitorin e pestë:	+ 25 %	500 €	150 €	195 €	845 €	
Përmbarrim në bazë të dokumentit të besueshëm me vlerë deri në lartësinë e kontestit të vlerës së vogël			60 €		18 €	78 €
Për kreditorin dytë / debitorin e dytë:	+ 50 %	90 €		27 €	117 €	
Për kreditorin tretë / debitorin e tretë:	+50 %	120 €		36 €	156 €	
Për kreditorin katërt / debitorin e katërt:	+ 50 %	150 €		45 €	195 €	
Për kreditorin pestë / debitorin e pestë:	+ 50 %	180 €		54 €	234 €	
Përmbarrim në bazë të dokumentit të besueshëm me vlerë mbi në lartësinë e kontestit të vlerës së vogël			80 €		24 €	104 €
Për kreditorin dytë / debitorin e dytë:	+ 50 %	120 €		36 €	156 €	
Për kreditorin tretë / debitorin e tretë:	+50 %	160 €		48 €	208 €	
Për kreditorin katërt / debitorin e katërt:	+ 50 %	200 €		60 €	260 €	
Për kreditorin pestë / debitorin e pestë:	+ 50 %	240 €		72 €	312 €	
Përmbarrim në bazë të dokumentit të besueshëm me vlerë 10.000,00 € e më lartë.			160 €		48 €	208 €
Për kreditorin dytë / debitorin e dytë:	+ 50 %	240 €		72 €	312 €	
Për kreditorin tretë / debitorin e tretë:	+50 %	320 €		96 €	416 €	
Për kreditorin katërt / debitorin e katërt:	+ 50 %	400 €		120 €	520 €	
Për kreditorin pestë / debitorin e pestë:	+ 50 %	480 €		144 €	624 €	
Përmbarrim në bazë të dokumentit të besueshëm me vlerë 100.000 € e më lartë			250 €		75 €	325 €
Për kreditorin dytë / debitorin e dytë:	+ 25 %	312,5 €		93,75 €	406,25 €	
Për kreditorin tretë / debitorin e tretë:	+25 %	375 €		112,50 €	487,50 €	
Për kreditorin katërt / debitorin e katërt:	+ 25 %	437,5€		131,25 €	568,75 €	
Për kreditorin pestë / debitorin e pestë:	+ 25%	500 €		150 €	650 €	

Nr. tarifor 7. – Përfaqësimi në seancat për çështje civile dhe të tjera:

Lloji i çështjes juridike dhe vlera		Baza	30 % ora	Paush 30%	Gjithsejtë:
Përfaqësimi në konteste të vlerës së vogël		60€	18 €	23,40 €	101,40 €
Për paditësin / të paditurin e dytë:	+50 %	90 €	27 €	35,10 €	152.10 €
Për paditësin / të paditurin e tretë:	+50 %	120 €	36 €	46,80 €	202.80 €
Për paditësin / të paditurin e katër:	+50 %	150 €	45 €	58,50 €	253.50 €
Për paditësin / të paditurin e pestë:	+ 50 %	180 €	54 €	70,20 €	304.20 €
Përfaqësimi në konteste që vlera e kontestit Mbi vlerën e kontestit të vogël e deri në 10.000 €		80€	24 €	31,20 €	135,20 €
Për paditësin / të paditurin e dytë:	+50 %	120 €	36 €	46,80 €	202.80 €
Për paditësin / të paditurin e tretë:	+50 %	160 €	48 €	62,40 €	270.40 €
Për paditësin / të paditurin e katër:	+50 %	200 €	60 €	78 €	338.00 €
Për paditësin / të paditurin e pestë:	+ 50 %	240 €	72 €	93,60 €	405.60 €
Përfaqësimi në kontestet me vlerë mbi 10.000 € e më lartë		160 €	48 €	62,40 €	270,40 €
Për paditësin / të paditurin e dytë:	+50 %	240 €	72 €	93,60 €	405.60 €
Për paditësin / të paditurin e tretë:	+50 %	320 €	96 €	124,80 €	540.80 €
Për paditësin / të paditurin e katër:	+50 %	400 €	120 €	156 €	676.00 €
Për paditësin / të paditurin e pestë:	+ 50 %	480 €	144 €	187,20 €	811.20 €
Përfaqësimi në kontestet me vlerë mbi 100.000 € e më lartë		250 €	75 €	97,50 €	422,50 €
Për paditësin / të paditurin e dytë:	+ 25 %	312,5 €	93,75 €	121,87 €	528,12 €
Për paditësin / të paditurin e tretë:	+25 %	375 €	112,50€	146,25 €	633,75 €
Për paditësin / të paditurin e katër:	+ 25 %	437,5 €	131,25€	170,25 €	739,37 €
Për paditësin / të paditurin e pestë:	+ 25 %	500 €	150 €	195 €	845 €

Shpërblimet tjera:

- 1 Për përpilimin e parashtrësive dhe përfaqësim në seanca për çështje civile të arbitrazhes si dhe kontesteve me element të huaj, zbatohet rritje për 100% e numrit tarifor 6 dhe 7.
- 2 Në bazë të nenit 4. të TA avokati me klientin e tij mundet që të kontrakttoj shpërblimin për punën e tij sipas marrëveshjes së lirë me klientin (në bazë të kontratës së lidhur)
- 3 Për veprimet e avokatit në procedurën kundërvajtëse apo disiplinore, shpërblimi llogaritet analogjikisht si për veprimet me bazë tarifore prej 60 €.
- 4 Për përpilimin e kontratave, ujdive, testamentit avokatit i takon shpërblimi sipas nr. tarifor 6. apo deri në 1 % të vlerës së tregut të pasurisë që është objekt i punës juridike përkatëse - nr. tar. 12.
- 5 Për azhurnim në çështje penale aplikohet nr. tar. 1. dhe në çështje civile nr. tar. 7.

Kjo tarifë është në fuqi nga data 18.03.2017

Kryetari i OAK
Osman Havolli

